



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 3

Prishtinë, më 30 mars 2010, në orën 11: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT TË SHËNDETËSISË, TË PUNËS
DHE TË MIRËQENIES SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Sasha Gjokiq, Flora Brovina, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Nazane Breca, Aurora Bakalli dhe Gëzim Kelmendi.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj - administratore e Komisionit, Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi, Lejla Selimi –OSBE, Natyra Kasumaj – KDI dhe Qëndresa Ismaili- praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 23.03.2011,**
- 3. Miratimi i Planit të punës të Komisionit për vitin 2011,**
- 4. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 23. 03. 2011

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së 23 mars 2011.

3. Miratimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2011

Fikrim Damka- Tha se Plani i punës është miratuar bazuar në strategjinë legjislative të Qeverisë. Sipas vendimit të Kryesisë, Plani i punës duhet të miratohet deri më 31 mars 2011, në mënyrë që deri më 8 prill 2011 të miratohet edhe Plani i punës i Kuvendit. Këtë plan ndërkohë mund edhe ta ndryshojmë dhe plotësojmë.

Time Kadriaj- Tha se ky plan duhet të përkrahet. Ndërkohë, ne mund të bëjmë ndryshime sipas rrjedhës së ngjarjeve. Ne, varësisht se cilin projektligj e kemi për shqyrtim, duhet t'i vizitojmë institucionet, puna e të cilave lidhet me projektligjin në fjalë.

Salihe Mustafa- Tha se duhet të miratohet Plani i punës së Komisionit, e gjatë punës të plotësohet.

Nazane Breca - Tha se duhet të miratohet Plani i punës së Komisionit dhe të plotësohet në vazhdim.

Bahri Thaçi- Tha se Plani duhet të miratohet. Do të ishte mirë që si Komision të bëjmë një vizitë në një vend ku hasim shumë njerëz që kanë probleme të mirëqenies sociale. Në Podujevë është një lagje që quhet “Lagja e Kuvajtit”, në të cilën jetojnë 132 familje të dëshmorëve dhe viktimave të luftës dhe familje në gjendje të rëndë sociale në kontejner, që prej mbarimit të luftës. Me këtë vizitë do të njoftoheshim me gjendjen për së afërmi dhe, pas kësaj, mund të japim propozime konkrete për ministritë e caktuara, për Kuvendin dhe për Qeverinë.

Flora Brovina- Tha se Plani duhet të ndahet në muajt përkatës. Janë disa ligje që duhet të monitorohen, si p.sh., Ligji i punës. Ose ta organizojmë një tryezë lidhur me këtë problematikë. Ka një shqetësim për sa i takon buxhetit të vogël të buxhetit të lehonisë. Duhet t'i thërrasim të dy ministrat dhe të njoftohemi nga ta për këto gjëra. Nga përvoja e di që gjëja e parë që duhet të bëhet në drejtim të përmirësimit të gjendjes në shëndetësi është ta kemi pasqyrimin e gjendjes në terren. Duke e pasur një sistem të informimit në sistemin shëndetësor, do ta kemi më lehtë të gjejmë zgjidhjet. Ka munguar një politikë e mirëfilltë e kuadrove.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri e miratoi Planin e punës së Komisionit për vitin 2011.

4. Të ndryshme

Time Kadriaj- Tha se është mirë të informohemi se çka ka ndodhur me rekomandimin që e ka dhënë Komisioni ynë, lidhur me buxhetin. Buxheti për mallra dhe shërbimë sivjet është shumë i vogël dhe do të kemi probleme të mëdha gjatë vitit.

Fikrim Damka- Tha se Komisioni i buxhetit e ka marrë rekomandimin tonë, por ai ka kërkuar shifra konkrete. Ministria e Shëndetësisë ka kërkuar 1.1 milion euro investime

kapitale, kërkesë e cila është miratuar. Në kohën e rishikimit të buxhetit do të kemi takime me ministrin.

Nazane Breca- Tha se në kujdesin parësor shëndetësor ka ulje të buxhetit. Kujdesi parësor ka nevojë për ngritje të buxhetit, sepse është themeli i kujdesit shëndetësor. Po ashtu, nuk bën të ulet buxheti për Inspektoratin shëndetësor dhe farmaceutik, sepse nuk mund të kemi cilësi pa një monitorim të mirë.

Salihe Mustafa- Tha se duhet të bisedojmë me ministrin, që të mos na bëhet vonë për rishikimin e buxhetit.

Aurora Bakalli- Tha se dua të shpreh një shqetësim të infermiereve të ndërrimit të natës në QKUK dhe në qendra të tjera, të cilave po parashihet t'u ulet shuma e mjeteve që marrin për një kujdestari të natës, nga 10 euro në 3 euro.

Gëzim Kelmendi- Tha se për kategoritë e punëtorëve shëndetësorë, që banojnë larg nga vendi i tyre i punës, të ketë lehtësime nga Ministria.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka